



Breaking News:

Shkodër/Ndërhyrja e shpejtë e Policisë parandalon një ngjarje të rëndë



14/07/2025

Shkodër/Ndërhyrja E Shpejtë E Policisë Parandalon Një Ngjarje Të Rëndë

Shkodër/Ndërhyrja e shpejtë e Policisë parandalon një ngjarje të rëndë.

Kanosi fqinjin e tij, duke qëlluar me armë zjarri pistoletë, në fshatin “Dobraç”, kapet në flagrancë dhe vihet në pranga 41-vjeçari.

Sekuestrohet arma e zjarrit pistoletë.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Shkodër, në bashkëpunim me shërbimet e Patrullës së Përgjithshme, të mbështetura nga Forca e Posaçme “Shqiponja”, menjëherë pas marrjes së njoftimit se në Dobraç, një shtetas kishte kanosur me armë zjarri, fqinjin e tij, kanë organizuar punën për kapjen e autorit dhe zbardhjen e rethanave të rastit.

Si rezultat i veprimeve të shpejta, u kap në flagrancë dhe u arrestua shtetasi S. J., 41 vjeç, banues në Dobraç.

Nga veprimet e para procedurale dyshohet se për motive të dobëta, shtetasi S. J. ka qëlluar me armë zjarri pistoletë, në tokë, për të kanosur fqinjin e tij, shtetasin A. K.

Materialet procedurale do t’i kaloj ë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital



GET IT ON

Google Play



Download on the
App Store

Arkiva

Select Month



Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)